



Pranuar / Dorezuar Punë/Prezantuar Received/Delivered	07.12	2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ./Jednitsa Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKRIPACK	5557/21		163	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Anr.929/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malësore Gashi Bajraktari dhe Arben Mehmeti-anëtarë dhe Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, sipas Aktgjykimit me numër A.nr.2073/21, të datës 12.11.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr. 621/2021 të datës 08.07.2021 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: fshati Opterushë Komuna e Rahovecit, kundër organit të punësimit Komunës së Rahovecit, në çështjen juridike “*Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.12.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar ankesa A.nr.929/2021 e datës 12.11.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. OBLIGOHET** Kryetari i Komunës së Rahovecit, që brenda afatit prej 15 ditës të bëjë zbatimin e këtij vendimi, duke i njohur ankuesit të drejtën e realizimit të pagës sipas Ndryshim dhe Plotësimit të Akt nga data e pranimit të këtij vendimi.
- III.** Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi fillimisht i punësuar në pozitën Zyrtar për Biznes dhe Statistika në Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim me datë 03.04.2013 është caktuar me vendim Nr. 01nr.1360 të Kryetarit të Komunës së Rahovecit, në pozitën e punës “Menaxher i Aseteve” me koeficient të pagës 7.5 në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim.

Meqenëse Komuna e Rahovecit nuk ka mundur të realizoj pagën për 0.5 të koeficientit në mungesë të buxhetit ankuesi ka parashtruar ankesë lidhur me realizimin e kësaj të drejte.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek komuna e Rahovecit. Më datë 27.07.2021 Komuna e Rahovecit, ka dërguar përgjigjen në ankesë me provat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesë e datës 08.07.2021 me numër Anr.621/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me nr. protokoll 3573/21; Aktgjykimi me numër A.nr.2073/21, i datës 12.11.2021, i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Njoftim i datës 17.08.2021; Njoftim i datës 06.08.2021; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 15.07.2021; Kërkesë drejtuar Kryetarit të komunës së Rahovecit me nr.2088 i datës 04.06.2021; Përgjigje në kërkesë e datës 02.07.2021; Shkresë përcjellëse me nr. 164 i datës 27.02.2018; Akt Emërimi me numër 01.nr.523 i datës 03.02.2012; Aktvendim me numër 01nr.1360 i datës 03.04.2013; Ndryshim dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit me numër 01nr.1362 i datës 03.04.2013; Përgjigje në ankesë e datës 27.07.2021; Përgjigje në ankesë e datës 23.07.2021; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Pliko me nr. R.1711270 i datës 23.07.2021; Lista e pagave për muajin Shkurt dhe Qershor 2021;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke vepruar sipas aktgjykimit të Gjykatës Themelore A.nr.2073/2021 me të cilin ka detyruar KPMSHCK që të nxjerr Vendim (për shkak të rrethanave të funksionimit të KPMSHCK-së), pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është pjesërisht e bazuar, sepse:**

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi, është punësuar në pozitën "Zyrtar për Biznes dhe Statistika" në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim me koeficient 7 sipas Akt Emërimit të datës 03.02.2012 në Komunën e Rahovecit, i njëjti më datë 03.04.2013 është avancuar në pozitën "Menaxher i Aseteve" në Drejtorinë për Ekonomi dhe Zhvillim me koeficient 7.5 sipas Aktvendimit të Kryetarit të Komunës së Rahovecit me numër 01nr.1360 të datës 03.04.2013, Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër 01.nr.1362 të datës 03.04.2013. Më datë 04.06.2021 me Kërkesë i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Rahovecit lidhur me zbatimin e koeficientit ndërsa më datë 02.07.2021 Kabineti i Kryetarit të Komunës i është përgjigje në kërkesën e parashtruar.

Ankuesi edhe pse i është caktuar koeficienti i pagës shtatë pikë pesë (7.5), i njëjti përmes parashtrimit të pretendimeve ankimore ka deklaruar se realizon pagën sipas koeficientit shtatë (7). Lidhur me këtë çështje, ankuesi, më datë 08.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3573/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, prandaj meqenëse ankuesi ka akt emërimin me koeficient 7.5 të cilin Komuna e Rahovecit e ka bërë me qëllim të plotësimit të vendit të punës për shkak të nevojave të Komunës, prandaj Komuna e Rahovecit ka obligim që të punësuarit ti bëjë pagesën konform akt emërimit në fuqi.

Andaj, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, përkatësisht nenin 9 paragrafi 1 ku përcaktohet se: "**Nëpunësit civil kanë të drejtë të marrin pagën bazë për numrin e orëve të përcaktuara në aktin e kontratës së punës**", si dhe duke marrë parasysh se ankuesi ushtron pozitën "Menaxher i Aseteve" sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit me numër 01.nr.1362 të datës 03.04.2013 me koeficient të pagës shtatë pikë pesë (7.5), prandaj obligimi i Komunës së Rahovecit për pagesën e pagës sipas akt emërimit rrjedhë konform dispozitave të lartshënuara ligjore.

Kolegji si rrethanë faktike dhe ligjore për **aprovimin e pjeshëm**, të ankesës ka marrë për bazë akt emërimit që ankuesi ka me 7.5 dhe është obligim ligjor që pagesa të realizohet konform dispozitave ligjore në fuqi., ndërsa diferenca e kërkuara nga ankuesi nuk aprovohet në mungesë të mjeteve bugetore.



Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.929/2021, me datës 12.11.2021.

Flakron GASHI

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankuesit .
- Gjyqtarit në GJTH-Prishtinë
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së

